

# HELSINKI COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS



## RAPORTI VJETOR LIDHUR ME GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË GJATË VITIT 2001

Ishte ky një vit në të cilin hapësira e praktikimit, e mbrojtjes dhe e përparimit të të drejtave të njeriut qe pothuaj e pamundshme nga shkaku se tendosja shumëvjeçare në marrëdhëniet ndëretnike, për fat të keq, përshkallëzoi me dhunë dhe u shndërrua në konflikt të armatosur. Në një situatë të tillë, jo vetëm që iu mbyll rruga realizimit të të drejtave të njeriut dhe ndodhi shkelja në masë të madhe e tyre, por qemë dëshmitarë edhe të lëkundjes së themeleve edhe ashtu të brishta të rendit të tillë institucional si parakusht për zotërimin e drejtësisë.

Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë bëri me dije vitin e kaluar se nuk qe e vërtetë ajo që pohonin liderët e partive politike në pushtet se marrëdhëniet ndëretnike janë stabile dhe të përmirësuara, porse ato vetëm në dukje mbaheshin nën kontroll nga partitë politike. Kjo gjë e arriti kulmin, siç dihet, me konfliktin e armatosur që ndodhi për shkak se liderët politikë në pushtet dhe partitë e tyre nuk u prenë hovin parashenjave të qarta të krizës me anë të dialogut dhe gjetjes së zgjidhjes, por ua kthyen shpinën atyre (ose i shfrytëzuan për qëllimet e veta) duke lejuar tendosjen e mëtejshme dhe rritjen e rrezikshme të kriminalitetit e të korrupsionit, të cilat, nga ana tjetër, me lehtësi iu bashkuan forcave militante.

Ka një kohë të gjatë që Komiteti i Helsinkut i kritikon dobësitë që shfaqen sa u përket të drejtave të minoriteteve, por është i mendimit se të drejtat e njeriut të pjesëtarëve të minoriteteve në Republikën e Maqedonisë në asnjë mënyrë nuk u rrezikuan aq shumë sa të arsyetohej realizimi i tyre me anë të armëve.

Së këtejmi, sipas Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut, Marrëveshja kornizë e Ohrit, si një kompromis politik që i hapi rrugë procesit të zgjidhjes së krizës, duhet të pranohet si parakusht i domosdoshëm nëpërmjet jetësimit të së cilës shteti do të mund të riinstitucionalizohet. Vetëm me kthimin e mirëbesimit të ndërsjellë dhe të vlerave e mënyrave të veprimit demokratik mund të arrihet niveli i tillë i sigurisë dhe stabilitetit që do të paraqesë bazën e respektimit dhe përparimit të të drejtave të njeriut.

Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut i Maqedonisë e sheh të udhës sidomos të nxjerrë në pah dy përmasa të shkeljes së të drejtave të njeriut në këtë situatë.

E para, shënon rrezikun e pranishëm në territoret ku ende nuk është vendosur jurisdiksioni i plotë edhe pas çarmatosjes së UÇK-së nga fundi i shtatorit të sivjemë. Në këto vise veprojnë lirisht grupe rebele ekstremiste dhe kriminale që e frikësojnë popullatën maqedonase, shkatërrojnë objekte fetare, bëjnë vjedhje dhe gjithë popullatën e mbajnë në ankthin e frikës. Hë për hë është me përparësi vendosja e rendit juridik në këto vende, kurse nxjerrja para organeve të hetuesisë e dhunuesve të ligjeve paraqet kushtin e domosdoshëm për të vazhduar koha e "pajtimit".

E dyta, shënon rrezikun aktual që paraqesin vetë forcat e sigurisë. Çdo formë e teprimi në ushtrimin e detyrës zyrtare dhe çdo rast torturimi e mundimi duhet të evidencohen doemos dhe të dënohen në mënyrë adekuate, me qëllim të kthimit të mirëbesimit të popullatës shqiptare ndaj përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. E gjithë kjo bëhet me synim të vendosjes së rendit juridik në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Ky raport vjetor i Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë konstaton gjendjen lidhur me të drejtat e njeriut para së gjithash në sferat vendimtare ku ishte më e shprehur mospërfillja e të drejtave të njeriut.

Vetëkuptohet se në vitin që shkoi pati shumë raste të mosrespektimit e të dhunimit të të drejtave të njeriut. Meqë Komiteti i Helsinkut ka kapacitete të kufizuara dhe në kushte konflikti të armatosur e tendosjeje të lartë ndëretnike në gjithë vendin, ai nuk arriti t'i hulumtonte të gjitha dukuritë e dhunimit të të drejtave të njeriut dhe me këtë edhe të përgatiste një raport më gjithëpërfshirës. Prandaj do t'u referohemi vetëm sferave vendimtare dhe dukurive më karakteristike që u shfaqën aty.

Ky raport përmban raportet mujore lidhur me shkeljet konkrete të të drejtave të njeriut që Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut i publikonte gjatë vitit, e të cilat mund të merren nga faqja-veb e Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë: [www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)

## **Të drejtat e minoriteteve dhe marrëdhëniet ndëretnike**

Problemi i marrëdhënieve ndëretnike në vitin 2001 në Republikën e Maqedonisë shënoi pikën më të lartë të mosdurimit. Gjendja lidhur me të drejtat e minoriteteve u deklarua si bazë për fillimin në shkurt të veprimeve luftarake të ekstremistëve nga radhët e minoritetit shqiptar. Ndarja në vijën etnike i mbylli në

mënyrë të ndjeshme kanalet e komunikimit ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike.

Në zonat e përfshira nga kriza, gjatë kohës së konfliktit të armatosur të drejtat e njeriut u katandisën në një shkallë të lartë rrezikimi të tyre, që u shpreh në dhunimin e të drejtës së jetës, të drejtës së mbrojtjes nga torturimi dhe mundimi, të drejtës së pronësisë, të drejtës së privatësisë, të drejtës së shkollimit, të drejtës për të shprehur lirisht mendimin dhe bindjet. Në dhunimin e të drejtave themelore të njeriut morën pjesë edhe "luftëtarët për të drejtat e njeriut" nga radhët e bashkësisë etnike shqiptare, edhe "mbrojtësit" e të drejtave të njeriut nga radhët e forcave të sigurimit të Republikës së Maqedonisë.

Mbeti e kontestueshme (në pikëpamje kushtetuese dhe ligjore) përfshirja e ushtrisë së Maqedonisë në konfliktin e armatosur. Pati bombardime vendbanimesh që shkaktuan dëme të mëdha materiale duke vënë në rrezik edhe jetën e popullatës civile.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar raste të rrëmbimit, të humbjes pa gjurmë dhe të marrjes peng të qytetarëve. Një pjesë e të rrëmbyerve janë keqtrajtuar dhe janë liruar, kurse një numër i konsiderueshëm civilësh (maqedonas e shqiptarë) nuk dihet se a janë gjallë ose jo. Për një pjesë nga të humburit nuk u bënë as fletarrestimet e zakonshme, edhe pse ata janë paraqitur si të humbur nga familjet e tyre.

Si rrjedhim i konfliktit të armatosur në muajt e kaluar në mënyrë të ndjeshme u prishën marrëdhëniet ndëretnike dhe duhet një proces i gjatë "pajtimi" që do të mundësonte kthimin e mirëbesimit dhe krijimin e kushteve për jetë të përbashkët. Edhe më tej po rrjedh procesi i pastrimit etnik (të qëllimshëm dhe për shkak të ngjarjeve të vrazhda), kështu që pa një veprim të ndërgjegjshëm, sistematik e të gjithanshëm të shtetit e të bashkësisë ndërkombëtare, ata do të synojnë territore plotësisht të pastra etnike dhe kjo gjë në masë të madhe do ta rikërcënojë komunikimin ndërmjet bashkësive etnike të ndryshme.

Në nivel deklarimi, shumica maqedonase pati qasje pozitive ndaj bashkësive të tjera minoritare që jetojnë në këtë shtet (romëve, turqve, vlllehëve, serbëve) si qytetarë lojalë, për dallim nga pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare që u perceptuan qytetarë jolojalë. Ky qëndrim pozitiv nuk u materializua në praktikë. Në Prilep, Manastir, Shkup, Veles gjatë trazirave iu vu zjarri shumë dyqaneve e shtëpive të turqve e të romëve (vetëm pse qenë myslimanë); u dogjën disa xhami dhe u përdhosën varrezat myslimane. Gjithashtu, sa u përket të drejtave të vlllehëve nuk u gjet ndonjë zgjidhje për kërkesat e tyre lidhur me mësimin shtesë në gjuhën vlllehe.

Si rezultat i polarizimit mbi bazë etnike, u shkaktua njëherit edhe polarizimi i etnive sipas përkatësisë fetare. Për shkak të identifikimit të etnive me simbolet fetare dhe religjioze të njëjës a të tjetrës palë në konflikt, gjatë krizës, po edhe pas Marrëveshjes kornizë, u shkatërruan e u përdhosën objekte fetare: disa xhami, kisha, manastire, që paraqesin një pjesë të trashëgimisë kulturore – historike në territorin e Republikës së Maqedonisë, por edhe varreza myslimane dhe të krishtera. Krahas objekteve fetare, gjatë trazirave në Prilep, Manastir, Shkup, Veles, iu vu zjarri edhe shumë dyqaneve e shtëpive që ishin prona të turqve, romëve, myslimanëve maqedonas (vetëm për shkak se ata ishin myslimanë). Gjithashtu, sa u përket të drejtave të vllahëve nuk u zgjidhën kërkesat e tyre lidhur me çështjen e mësimin shtesë në gjuhën vllahë.

Marrëveshja kornizë hap një perspektivë të rëndësishme sa i përket zgjidhjes së problemit të të drejtave të minoriteteve në qoftë se ajo shfrytëzohet për vendosjen dhe afirmimin e demokracisë e të kompleksit të vlerave demokratike. Megjithatë, duhet konstatuar se krahas procesit të jetësimit të tij (ndryshimeve kushtetuese, procesit të amnistisë, miratimit të ligjit për qeverisje lokale etj.) u shfaq dhe u formësua procesi i pamundësimit të tij institucional. Ky proces u shfaq më qartë në veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo ministri në një mënyrë kontraverze formoi njësinë speciale njënacionale me emrin "Luanët", e cila ka simbol të ngjashëm me atë të partisë në pushtet VMRO – DPMNE. Ministria e Punëve të Brendshme sivjet më 9 nëntor si mbrojtës të vet shpalli shenjëtorin Shën Dhimitri, me çka e shpalli veten edhe si njëetnike edhe si njëkonfesionale. Kjo gjë bie në kundërshtim me synimin themelor të marrëveshjes kornizë - Maqedonia të ndërtohet si shtet shumetnik i qytetarëve që jetojnë në të.

Nga ana tjetër, partitë politike shqiptare përmbahen nga dënimi publik i ekstremistëve shqiptarë që ende mbajnë armë dhe shkaktojnë incidente shqetësuese. Ajo që brengos edhe më shumë është fakti se nuk dihet ose me qëllim pësjtjellohet përcaktimi i grupeve të armatosura në kuptimin se a janë mbetje të UÇK-së, pjesëtarë të ndonjë grupi të ri paramilitar (bie fjala AKSh), ose bëhet fjalë për grupe kriminogjene të formuara nga pjesëtarë të minoritetit shqiptar. Sido që të jetë, këto janë dukuri që e vënë në rrezik procesin paqësor.

### **Pozita e të shpërngulurve brenda vendit dhe e refugjatëve**

Gjatë konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë brenda vendit u shpërngulën rreth 72 000 njerëz (në radhë të parë maqedonas nga Tetova, Kumanova dhe fshatrat përreth këtyre dy qyteteve). Gjatë kësaj periudhe shkuan në Kosovë, Serbi Jugore dhe në Turqi më se 58.000 refugjatë (sidomos shqiptarë). Pas nënshkrimit të Marrëveshjes kornizë një pjesë e madhe e refugjatëve (mbi 35.000) dhe një pjesë e konsiderueshme e personave të

shpërngulur brenda vendit (40.000) u kthyen në vendbanimet e tyre. Pushteti zhvilloi një strategji për kthimin e plotë e të shpejtë të të gjithë personave të shpërngulur. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare pati një trysni kolektive dhe individuale për kthimin e këtyre njerëzve, pa përfillur dëshirën e tyre, në vendbanimet e tyre, në vendbanimet ku ende nuk ishte arritur siguria elementare për të jetuar (ku edhe më tej ishin të pranishme grupet e armatosura të ekstremistëve shqiptarë që rrezikonin jetën dhe shëndetin e qytetarëve), ku nuk ishte vendosur pushteti i drejtësisë dhe ku nuk ishin plotësuar kushtet minimale për kthimin e tyre (shtëpitë e pamermetuara, mungesa e energjisë elektrike, e ujit, mosriparimi dhe mosaftësimi i ambulancave dhe shkollave). Ky qëndrim shkaktoi një rezistencë të fuqishme te personat e shpërngulur brenda vendit dhe krijoi tendosje shtesë. Një pjesë e madhe e personave të shpërngulur brenda vendit nuk qenë të përkujdesur në mënyrë përkatëse dhe atyre iu rrezikuan shumë nga të drejtat themelore të njeriut (shkollimi, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor, ribashkimi i familjes).

Hë për hë në shtetin tonë ka ende romë, goranë, serbë dhe popullatë tjetër joshqiptare që kap shifrën prej 3.410 vetash. Në bazë të një përfundimi që nxori qeveria e Republikës së Maqedonisë në dhjetor të vitit 2001 ende nuk ishin krijuar kushtet për kthimin e tyre në Kosovë dhe me këtë vendim atyre u jepej statusi i personave me përkujdesje të përkohshme në Republikën e Maqedonisë, deri në muajin mars të vitit 2002.

### **Tejkalime kompetencash të policisë**

Mosrespektimi i përcaktimeve juridike të autorizimeve policore edhe më tej në praktikë paraqitet si burim i problemeve të shumta. Nga njëra anë, përcaktimet kushtetuese fuqimisht ndjekin konceptin e të drejtave dhe lirive të njeriut në përcaktimin e autorizimeve të policisë sa i përket burgosjes, bastisjes, përgjimit dhe marrjes në pyetje. Nga ana tjetër, me ligjet dhe aktet nënligjore nuk përcaktohen qartë autorizimet e policisë, nuk ka mekanizma kontrolli dhe sanksionimi efektiv lidhur me mosrespektimin e procedurave e të rregullave. Në këtë kontekst, policia e sheh të udhës se është e arsyeshme moralisht që ta vendosë (po edhe ta dhunojë) drejtësinë me synim të deklaruar ta avancojë zbulimin e veprave kriminale e të autorëve të tyre.

Policia maqedonase e bëri shprehi që në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese, t'i burgosë personat e dyshuar, të bastisë e të marrë gjëra të ndryshme pa pasur paraprakisht urdhëresë nga gjyqi. Ngjashëm me këtë, personat e dyshuar nuk nxirren menjëherë në gjyq, por sipas rregullit mbahen në polici madje shpeshherë më se 24 orë. Gjithashtu, personave të dyshuar policia nuk ua bën me dije të drejtat e tyre për të heshtur ose për të pasur mbrojtës para se të merren në pyetje. Ndonjëherë jepen instruksione të këtij lloji, por në të shumtën e rasteve ato nuk janë complete dhe korrekte. U bënë të shpeshta

rastet e mbajtjes së personave ekskomunikado, pra burgosja e personave dhe mbajtja e tyre pa treguar se ku ndodhen, pa njoftuar familjen ose avokatin. Praktika e kontestueshme e dosjeve policore të pamjaftueshme për hapjen e procedurës për personat e dyshuar tashmë u bë absurde, me mosregjistrimin komplet të personave të ndaluar dhe të mbajtur në polici. Mungesa e regjistrimit përkatës të ndalesës në polici më tej ka si rezultat tejkalin e një varg përcaktimesh ligjore dhe pamundësinë për t'u dëshmuar tejkalimi i autorizimeve të policisë, sidomos për rastet e torturës e të trajtimit çnjerëzor gjatë procesit të burgosjes dhe gjatë qëndrimit në polici. Janë shënuar tri raste trajtimi joadekuat dhe procedimi me të mitur shqiptarë.

Në mënyrë të veçantë shqetëson prania e pjesëtarëve të Drejtorisë së sigurimit dhe kundërzbulimit gjatë ndalimit dhe marrjes në pyetje të personave të dyshuar për terrorizëm, të cilët me këtë rast kanë sjellje që është plotësisht jashtë procedurave të përcaktuara policore.

Tash për tash nuk ka mjete juridike të mjaftueshme kundër veprimeve joligjore dhe të parregullta policore. Nuk ndiqen penalisht rastet jo të rralla të rrahjes dhe frikësimit të personave të dyshuar me qëllim të marrjes së të dhënave ose pranimit të fajit. Policia dhe prokuroria shprehin mospajtim të madh ndaj hetimit të rasteve të tejkaimit të autorizimeve të policisë, ose madje nuk pranojnë të dëshmojnë kundër kolegëve të tyre për shkeljen e ligjit. Disa nga këto tejkalime tolerohen hapur, madje edhe nxiten nga autoritetet më të larta policore, por nuk merren masa disiplinore ndaj atyre që kanë bërë tejkalime autorizimi, ose madje masat e këtilla nuk i përgjigjen sa duhet fajit të bërë. Gjatë vitit të kaluar, lufta me grupet ekstremiste dhe terroriste përdorej si pretekst për rrënimin e kufijve themelorë të lirive dhe të drejtave të njeriut. Rastet e vrasjes së një numri të madh të pjesëtarëve të forcave të sigurimit u kurorizuan me raste të "hakmarrjes" së hapur. Rastet e tejkalimit në Luboten, në spitalin e shtetit e të tjera janë shqetësuese edhe për faktin e dukurisë së sindromit "Dirty Harry" të shkeljes së ligjit me qëllim të efektivitetit më të madh. Po kështu është shqetësues edhe fakti se mediat në gjuhën maqedonase, prokuroria dhe gjykatat treguan "tolerancë" sa u përket tejkalimeve që bëri policia lidhur me kundërvënien ndaj ekstremizmit shqiptar.

Na shqetëson edhe institucionalizimi legal i njësisë speciale policore "Luanët". Kjo njësi është njënacionale dhe si duket përfshin edhe shumë kriminelë të mëparshëm, ndërkaq nuk është në nivelin e duhur as aftësimi i tyre në pikëpamje të autorizimeve policore.

### **Të drejtat e punonjësve të policisë**

Se sa është e ndërlikuar dhe kopmleke situata lidhur me të drejtat e njeriut në Maqedoni, mund të shihet edhe nga përpjekja jonë për të dhënë një pasqyrë të

shkeljes së të drejtave të njeriut të personave që kanë detyra dhe autorizime të posaçme.

Një numër i madh pjesëtarësh të vrarë të forcave të sigurimit ishin viktime të pakujdesisë dhe joprofesionalizmit të strukturave udhëheqëse. Koha mesatare e punës e një punonjësi me detyra dhe autorizime të posaçme duhet të jetë 208 orë pune në muaj, mirëpo kjo mesatare në praktikë u rrit në 280 orë. Disa nga këta punonjës ishin të ngarkuar me 32 orë punë jashtë orari në muaj, kurse që nga marsi e këtej, gjatë krizës së luftës, kjo mbimesatare ishte nganjëherë edhe 104 orë në muaj. Numri i kësaj kategorie të punonjësve që nuk e shfrytëzuan pushimin vjetor të vitit të kaluar u bë 80 për qind e të punësuarve.

Shkollimi dhe aftësimi i rregullt i tyre u lanë pasdore në tërësi. Formacionet rezervë nuk aftësoheshin lidhur me të drejtat e policisë, taktikën policore, kriminalistikën dhe legjislacionin. Munguan fare aftësimi për të drejtat e njeriut dhe ndërtimi i etno-sensibilitetit.

Në asnjë moment krize (veçmas në situatat e viktimave të shumta njerëzore) nuk pati qasje ndaj trajtimit të veçantë psikologjiko-psikiatrik ose debriefing përkatës, për çka këta persona shumë lehtë prirën nga përdorimi i dhunës për zgjidhjen e situatave të përditshme në punën e tyre.

Pas dhjetë vjet zhvillimi demokratik të Republikës së Maqedonisë u imponua nevoja e reformave në sistemin e kundërzbulimit dhe përshtatja e tyre me nevojat e mirëfillta të sigurisë së shtetit në përputhje me standardet e demokracive evropëndimore.

Kërkesat reformuese të shërbimit zbulues dalin nga konstatimi se Republikës së Maqedonisë i nevojitet një shërbim zbulimi i fuqishëm, i aftë, fleksibil dhe shumë i profesionalizuar.

Orientimet për ndryshime në shërbimin e zbulimit nuk duhet të kenë synim artikulimin e një interesi të caktuar politik, por ato duhet të kenë qëllim ta bëjnë sa më efektive e më të përsosur punën e këtij shërbimi në interes të sigurisë së Republikës së Maqedonisë.

## **Gjendja në gjyqësi**

Ndonëse që nga themelimi i pushtetit gjyqësor në republikën e Maqedonisë si pushtet i pavarur dhe i veçantë kaloi një periudhë e caktuar, megjithatë gjyqësisë i mbetën edhe më tej problemet që i kishte në vitet e mëparshme, madje në të vërtetë fitohet përshtypja se këto u rritën.

Duke qenë të pakënaqur me kushtet dhe të ardhurat e tyre, punonjësit e gjykatave e të administratës bënë grevë disamujore duke paralizuar gjyqet. Të

gjitha lëndët e caktuara, përveç lëndëve për paraburgim dhe lëndëve të tjera urgjente, u shtynë për më tej dhe kjo gjë solli grumbullimin e madh dhe mbetjen në procedurë të zgjidhjes të edhe ashtu shumë procedurave gjyqësore të ngadalshme.

Si duket problemi më i madh në procedimet qytetare edhe më tej mbetet dorëzimi me rregull për ndonjërin nga palët ose për pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, si kusht i mbajtjes së seancave gjyqësore. Afatet shtyhen pa nevojë dhe zgjatin shumë pikërisht nga shkaku i mospjesëmarrjes në dorëzim.

Sa u përket kontesteve të punës, gjyqet, nganjëherë të shtyra si duket nga nevojat sociale, janë në anën e punëtorëve që kërkojnë shfuqizimin e vendimeve të miratuara për pushimin e marrëdhënies së punës për shkak të shkeljes së disiplinës në punë dhe këta punëtorë i kthejnë në punë. Nga ana tjetër, përsëri në procedurat gjyqësore lidhur me kontestet e punës, ku si paditës paraqiten qindra punëtorë, kurse si të paditur dalin disa subjekte të mëdha e me rëndësi ekonomike, paraqitet zvarritja e procedurës gjyqësore duke zgjatur këto konteste me vjet.

Në procedurat penale, duke u nisur nga ngjarjet aktuale në Republikën e Maqedonisë, u zhvilluan procesime për shumë lëndë gjyqësore për veprën kriminale – terrorizëm. Gjatë kontrollit të lëndëve gjyqësore u pa se shpeshherë të akuzuarit, ndonjëherë edhe pa dëshmi të qëndrueshme, janë ngarkuar me këtë vepër penale, kurse gjyqet e pranojnë praktikën e procedurës policore të bërë keq ose jashtë ligjit, ku nuk janë siguruar dëshmitë e mjaftueshme ligjore. Me këtë rast, edhe pa gjendjen faktike të vërtetuar e të pakontestuar, për lëndët e këtilla fare lehtë u shqiptuan dënime me një kohëzgjatje efektive në burg.

Është shqetësues sidomos trajtimi joadekuat gjatë dënimit që bëhet në raste kur të akuzuarit i përkasin etnisë maqedonase në raport me dënimin e shqiptarëve për veprat e njëjta, më shpesh lidhur me veprat sipas nenit 396 të KP të RM-së për armëmbajtje pa leje ose për materiale shpërthyes. Shqiptarët marrin dënime më të rënda sesa maqedonasit, e cila gjë është vërtetuar duke krahasuar disa shembuj, dhe kjo çon, tek e fundit, në pasigurinë juridike dhe mosbesimin ndaj gjyqeve.

### **Kushtet në burgje**

Të gjitha raportet e deritanishme të Komitetit të Helsinkut i kanë vlerësuar të këqija kushtet në burgje. Nga vizita në burgun e Idrizovës përshtypja më e keqe fitohet nga qelitë ku rrijnë personat, të cilëve u është shqiptuar dënimi disiplinor. Këto janë dhomëza me 10 deri 12 metra katrorë, pa ngrohje, kurse një dritare e vogël e vetme rri gjithmonë mbyllur. Për kryerjen e nevojave fiziologjike i burgosuri ka vetëm një kovë të rëndomtë. Të huajt dhe pleqtë e paafte për punë



janë të vendosur në një lokal të veçantë; megjithatë ata mbahen të mbyllur në dhomat e qëndrimit, me të drejtë të kufizuar për të shëtitur.

Kuzhina ndodhet në një vend të mbyllur, kurse ushqimi gatuhet në kushte tejet johigjienike. Ambulanca gjendet menjëherë pranë kësaj kthine të mbyllur, kurse kushtet janë nën çdo nivel, sidomos mjeku i ri ka sjellje shumë e ulët dhe arrogante.

Një problem të veçantë, sidomos gjatë dimrit paraqet ngrohja, e cila nuk funksionon fare në ambulancë të të sëmurët, ndërsa në qeli as që ka instalime të tilla. Kërkesat e të burgosurve për kontrollim mjekësor thjesht nuk pranohen, kurse takimi me edukatorët pothuaj nuk ekziston.

Lokalet janë të papastra, kundërmon erë e keqe, muret janë të rezbitura, shkallët të prishura, kurse dyshemeja sikur fare nuk ekziston. Shtrojat e të burgosurve nuk ndërrohen, përveç atëherë kur ata vetë e kërkojnë një gjë të tillë.

Është gjë pozitive se të miturit e gjinisë mashkullore janë të veçuar dhe të vendosur në burgun e Ohrit.

Narkomanët marrin terapi të rregullt, kurse janë të vendosur nga 14 veta në një dhomë. Ata kanë të drejtë për të shëtitur vetëm dy orë, kurse kur e kërkojnë mjekun, ai vjen shumë rrallë.

Për punën që bëjnë, të burgosurit marrin nga 500 deri 2.500 denarë, varësisht nga puna që kryejnë. Sa i përket numrit të personelit të burgut, në 10 të burgosur është një punonjës, kurse standardet botërore thonë se ky numër duhet të jetë 1:2.

Pjesa e burgut ku rrijnë femrat ka dallime pozitive. Kushtet higjienike aty janë shumë më të mira, respektohet orari ditor, ngrohja punon, mund të shfrytëzohet foltorja e telefonit në mënyrë të pakufizuar, vizitat e mjekut janë të rregullta, kurse kontaktet me edukatorët janë të përditshme. Problemi për të cilin ankohen femrat e burgosura është pamundësia e punës së vazhdueshme ose edukimi.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve në burgje, po realizohen dy projekte lidhur me riparimin e disa pjesëve të burgut. Është bërë marrëveshja që riparimi të bëhet sipas standardeve perëndimore, që do të thotë më shumë qeli për më pak të burgosur ose dy deri katër veta në një qeli burgu, me mundësi për të shikuar televizor ose për të huazuar a për të sjellë në burg televizorin e vet. Tashmë është riparuar dhoma e pranimit, kurse po bëhet riparimi i lokaleve që do të shfrytëzohen si ambulancë.

## **Mediat dhe liria e shprehjes**

Informimi i përgjithshëm medial gjatë vitit 2001 kryesisht i kushtohej konfliktit të armatosur në territorin e Republikës së Maqedonisë. Duke qenë se fjala ishte për ngjarje për të cilat gazetaria maqedonase nuk kishte kurrfarë përvojë profesionale, u bënë e po bëhen shumë gabime gjatë informimit, e cila gjë shkaktoi edhe një shkallë të lartë keqinformimi të publikut. Për fat të keq, mund të thuhet se asnjë nga mediat nuk u përpoq të ruajë dinjitetin profesional në frymën e standardeve të vendosura ndërkombëtare. Në mos tjetër, mediat thjesht u bënë ose peng të paragjytimeve të veta etnike, ose ndoqën interesat e caktuara partiake. Gjatë krizës, gazetarët treguan një shkallë shumë të ulët të profesionalizmit, të etikës gazetare dhe të njohjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Asnjë nga shtëpitë informative, si në gjuhën maqedonase, ashtu edhe në gjuhën shqipe, nuk arritën t'i shmangen euforisë nacionaliste dhe pjesa dërrmuese e informacioneve u thurrën sipas interesit të etnisë që i përkiste gazetari, ashtu që informacionet u shndërruan në pamflete politiko-propaganduese. Madje në faqet e ngjarjeve të politikës së brendshme gjetën vend edhe njoftimet e kronikës së zezë, në mënyrë që edhe ato të vihen në funksion të interesit të ngushtë të etnisë që i përkiste media.

Me rritjen e krizës u shtua edhe numri i shkrimeve ku gjenin shprehje paragjykimet kombëtare dhe praktikohej gjuha e urrejtjes. Në raportimet e mediave nuk mbahej llogari për të drejtat dhe liritë e njeriut, u shpërfill premisa e pafajësisë, u shpif, u nëpërkëmb dinjiteti i njerëzve dhe mori hov urrejtja dhe mosdurimi kombëtar dhe fetar. Prej asnjërit nga mediat nuk mund të merrej informacion asnjans, qasje e balancuar dhe shikim i gjithanshëm i ngjarjes së paraqitur. U pengua, në mos edhe u bë e pamundshme, e drejta e konsumuesit të medias, e publikut, për të nxjerrë vetë përfundime. Gjatë njoftimeve që bënte, një pjesë e madhe e medias shfrytëzoi paraqitjen e deklaratave të njëanshme (të politikanëve, të funksionarëve ose të "ekspertëve") dhe e lanë pas dore nevojën e karakterit autentik të informacionit.

Dhunimi i të drejtave të njeriut ishte lajm në media vetëm atëherë kur bëhej fjalë për interesin e bashkësisë së vet etnike. Kjo qasje nuk i la shteg kurrfarë mundësie të ndikimit të opinionit publik i mbështetur në konceptin për të drejtat e njeriut, tolerancën dhe respektimin e dallimeve.

Të gjitha mediat, pa përjashtim u bënë bartëse të propagandës së luftës në favor të bashkësisë së vet etnike. Kulmi i një sjelljeje të këfillë u arrit atëherë kur u shfaq një gazetare duke gjuajtur me topin e ARM-së mbi një fshat në hapësirën e konfliktit të armatosur.

Gjatë krizës disa herë autoritetet e penguan lirinë e informimit (duke ndërhyrë drejtpërdrejt në mediat në gjuhën shqipe), kurse një gazetare u sulmua fizikisht gjatë kohës kur ajo bënte punën e vet.

Ka shenja trysnie të tërthortë ndaj disa shtëpive gazetare dhe ndaj disa gazetarëve. Më e keqja qëndron në faktin se vetë mediat (pjesa më e madhe e tyre) vihen në funksion të interesave etnike, që përkon me dukurinë e autocenzurës të gazetarët që vetes ia kanë ngarkuar detyrën jo ta mbrojnë profesionin dhe lirinë e informimit e të shprehjes, por interesat e kolektivitetit etnik. Situata lidhur me mediat në Republikën e Maqedonisë është tejet brengosëse, sidomos kur të merret parasysh nevoja e domosdoshme e përkrahjes së procesit paqësor.

## **Të drejtat e fëmijëve**

Edhe gjatë vitit 2001 mbetën mungesat dhe problemet që ishin të pranishme në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë viteve të mëparshme. Mund të thuhet se gjatë vitit 2001, duke u nisur nga gjendja aktuale politike dhe e sigurisë në vend, në disa fusha të caktuara ato edhe më shumë u keqësuan.

Gjatë konfliktit të armatosur, i cili zgjati disa muaj në Republikën e Maqedonisë, në rajonet e krizës u rrezikuan shumë nga të drejtat themelore të fëmijëve. Fëmijët u keqpërdorën për qëllime politike, pati situata kur ata jetën e kishin në rrezik, kur atyre iu dha armë dhe u përfshinë në veprimet luftarake, kur u torturuan dhe u munduan nga ana e forcave të sigurimit, kur në mënyrë joadekuate u ndaluan, u burgosën dhe iu bë gjyqi, patën stresa të vazhdueshme traumatike, mbetën pa kushte themelore të jetës (ushqim, ujë, barna, banim etj.), pastaj kur ata u nxitën për urrejtje kombëtare dhe fetare. Gjatë gjithë kësaj periudhe që vështirësuar realizimi i të drejtës së shkollimit të fëmijëve në rajonet e krizës.

Gjendja e vështirë ekonomike në vend, me më se 76.000 familje që shfrytëzojnë ndihmë sociale, me më se 53.000 persona të shpërngulur brenda vendit, me fëmijë prindërit e të cilëve disa muaj nuk kishin marrë rrogë, e ndërlikoi në mënyrë plotësuese situatën.

Edhe më tej mbetet aktuale nevoja për reforma në rregullativën ligjore sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Kjo gjë ka të bëjë para së gjithash me përcaktimin e fëmijëve si bartës (subjekte) të të drejtave, me mbrojtjen nga diskriminimi, me sigurimin e interesit sa më të mirë të fëmijës si përparësi në të gjitha rastet, me të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me ta.

Në publik ende nuk është përhapur sa duhet informimi dhe njohja e publikut, para së gjithash e prindërve dhe e vetë fëmijëve lidhur me të drejtat e fëmijëve. Me të drejtat e fëmijëve nuk njihen sa duhet as profesionistët, punonjësit socialë, arsimtarët, gazetarët, avokatët etj. Projektet e jetësimit të Konventës për të drejtat e fëmijës për shkollim edhe më tej mbeten në shkallën e eksperimentimit.

Ekzistimi i statistikës së zezë, përkatësisht i shifrave të zeza për fëmijët viktime të dhunës familjare, të keqpërdorimit seksual, të fëmijëve të lënë në rrugë e të ngjashme, tregon mungesën e transparencës së nevojshme lidhur me problematikën e të drejtave të fëmijëve.

Si një gjë pozitive (ndonëse të pamjaftueshme) mund të përmendet veprimtaria e Komisionit shtetëror për përpunimin dhe jetësimin e Planit shtetëror të veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, si trup qeveritar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe UNICEF-i lidhur me zbatimin e bashkëpunimit më të ngushtë e më efektiv ndërmjet institucioneve qeveritare dhe organizatave joqeveritare sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

### **E drejta e jetës dhe e mjedisit jetësor**

Çështjet që lidhen me të drejtën për të jetuar në mjedis të shëndetshëm janë ndër më të lënat pas dore në Republikën e Maqedonisë. Edhe pse është Ministria e veçantë e mjedisit jetësor, në Republikën e Maqedonisë po vazhdojnë proceset e ndotjes dhe mungesa e vetëdijes ekologjike në të gjitha nivelet e shtetit.

Si burime të drejtpërdrejta dhe më të mëdha rreziku të këtyllë në Maqedoni janë: KEM "Jugohrom" në Jegunovcë, KEMR në Manastir, KKM "Zletovo" në Veles, Minierat e plumbit dhe zinkut në Probishtip dhe OHIS-i në Shkup.

Vendgrumbullimi i mbeturinave të kromit të "Jugohrom"-it e ndot lumin Vardar e ujërat nëntokësore dhe i kanoset burimit në Rahçë prej ku e merr ujin Shkupi. Nga prodhimtaria e shkrites së Velesit përftohen mijëra tonë nga të cilët lirohen sasi të mëdha dioksid sulfuri dhe pluhur që përmban plumb, zink dhe kadmium. Pasojat e rënda shëndetësore për banorët e Velesit tashmë janë dëshmuar me anë të hulumtimeve të bëra gjatë realizimit të projektit "Profili biokimik i fetuseve nga rajoni i Velesit". Në pjesët e nxjerra nga placenta e lehonave pas lindjes që ishin prej Velesi është shënuar sasi tri herë më e madhe e plumbit në krahasim me ato të Shkupit, që po kështu jetojnë në mjedise të ndotura. Minierat e plumbit dhe zinkut në Probishtip prodhojnë 1.000 tonë koncentrat zinku dhe 800 tonë koncentrat plumbi në ditë. Sasitë e mëdha të pluhurit paraqesin rrezikun e drejtpërdrejtë për jetën e banorëve të Probishtipit. Termoelektrana e Manastirit lëshon shumë tonë dioksid sulfuri dhe pluhur tjetër ku përmbahen jo vetëm metale të rënda, por edhe komponime uraniumi. Janë në rrezik burimet e ujit të pijshëm. Në ajrin e mjedisit të kryeqytetit të Shkupit OHIS-i lëshon mija tonë dioksid sulfuri, okside të azotit dhe pluhur. Përreth fabrikës gjithmonë ka me mija tonë zhivë të depozituar, kurse tash njëzet vjet ruhen në basene betoni dhjetë mijë tonë përzierje izimeresh HCH, ndërsa uji i mbetur, i papastruar, derdhet në lumin Vardar.

Të tri liqenet natyrore të Republikës së Maqedonisë (i Ohrit, i Prespës dhe i Dojranit) i kërcënon vdekja e qetë duke u tharë, që nënkupton edhe vdekjen e një ekosistemi të tërë unikal karakteristik për këto hapësira.

Ekspertët bëjnë me dije gjendjen shumë të rëndë dhe kërkojnë të merren masa. Mosaktivitetin e vet shteti e arsyeton me mungesën e mjeteve, por edhe më tej mbetet fakti se nuk ka një angazhim aktiv e pozitiv lidhur me mbrojtjen e mjediseve të natyrës si një dukuri e përgjithshme në vend.

Lidhur me këtë një aspekt të veçantë paraqet ndotja e shkaktuar nga veprimet e armatosura në vendet fqinja dhe konflikti i armatosur në territorin e Republikës së Maqedonisë. Vetëm në nivel indikacionesh përmendet ndotja e shkaktuar nga ndërhyrja e forcave të sigurimit në territorin e shtetit, si dhe informacioni rreth "sindromit ballkanik" si shkak i mundshëm i vdekjes që 21 ushtarëve të NATO-s dhe i 30 të sëmurëve të tjerë nga sëmundje kancerogjene. Si shkaktar i mundshëm i këtyre sëmundjeve përmenden edhe projektilet e shfrytëzuara nga NATO gjatë luftës në Bosnjë dhe sulmeve mbi Republikën Federative të Jugosllavisë, mirëpo ende nuk ka hapa konkretë për përcaktimin e gjendjes faktike dhe për mbrojtjen e popullatës.

\*\*\*

Viti 2001 shënoi vitin kur tendosjet e fshehura në marrëdhëniet ndëretnike arritën kulmin me konfliktin e armatosur, i cili mund ta çonte vendin drejt luftës qytetare me pasoja të paparashikueshme. Falë dialogut midis liderëve të partive politike më të mëdha dhe përfaqësuesve me rëndësi nga bashkësia ndërkombëtare, më 13 gusht të vitit 2001 u nënshkrua në Ohër Marrëveshja kornizë me të cilën palët e përfshira sa janë të kënaqura, aq edhe nuk janë dhe e kritikojnë. Kemi shpresë se se po bëhet gjithnjë e më e qartë se kompromisi ishte dhe mbetet edhe më tej një nga mënyrat për t'iu shmangur asaj më të keqes, të ruhet shteti dhe të shihet një rreze paqe e bashkëjetese si dhe për themelimin e një shoqërie demokratike multietnike me të gjitha parakushtet e respektimit dhe përparimit të të drejtave të njeriut.

Komiteti i Helsinkut është i vetëdijshëm se vetë Marrëveshja kornizë, miratimi i amendamenteve të kushtetutës dhe zgjidhja me kompromis e problemit të amnistisë shënojnë hapat fillestarë për ndërtimin e shtetit të themeluar e të zhvilluar sipas parimeve qytetare, ashtu siç është i vetëdijshëm edhe për praninë e shumë kurtheve, të cilat vetëm me anë të përpjekjeve konstruktive në frymën e Marrëveshjes kornizë mund të zbulohen me kohë, të pengohen dhe të bëhen të pamundshme.